



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 80.
Prishtinë, më 26.11.2013 në ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Glauk Konjufca, Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Munguan: Lirije Kajtazi, Petar Miletic, Vesna Mikic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues i Sekretariatit të KKK, përfaqësues nga ECMI, përfaqësues nga ZPRK, përfaqësues nga CRDP, përfaqësues nga EVSR/EU OFFICE, përfaqësues nga RTK 2 dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, praktikante e UNDP- së- Fjolla Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković** Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.11.2013;**
- 3. Njoftim i grupeve punuese për punën e arritur gjatë monitorimit të zbatimit të ligjeve;**
- 4. Të Ndryshme.**

Kryesuesja - konstatoi se janë krijuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 18.11.2013.

Kryesuesja - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18.11.2013, pa vërejtje.

3. Njoftim i grupeve punuese për punën e arritur gjatë monitorimit të zbatimit të ligjeve;

Kryesuesja – në fjalën e saj tha se duke u bazuar në Planin e Veprimit, Grupet punuese të komisionit për të Drejtat e Interesave të Komuniteteve dhe Kthim janë në fazën e monitorimit të zbatimit të ligjeve si: Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, Ligji për Fshatin Hoçë e Madhe, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Ajo ceku se në këtë periudhë Grupi Punues është duke monitoruar edhe Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas, 2009-2015.

Në kuadër të monitorimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, grupi punues ka vizituar Komunën e Prizrenit, ku është hasur një situatë më të mirë se sa kemi paramenduar, përveç problemeve buxhetore që i ka paraqitur Kuvendi Komunal dhe Drejtoria e Urbanizmit.

Po ashtu, grupi punues ka vizituar edhe Kuvendin Komunal në Rahovec dhe Fshatin Hoçë e Madhe. Mund të thuhet se Komuna nuk është duke e zbatuar Ligji për Fshatin Hoçë e Madhe nga se problem kyç ishte mos formimi i Këshillit dhe mungesa e mjeteve buxhetore. Kryetari i komunës së bashku me Drejtorin e Urbanizmit kishin vërejtje për Ministrin e Planifikimit Hapsinor, Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Ishte e mendimit që pas përfundimit të fazës së vizitave, Komisioni të organizojë Debat Publik, të ftohen përfaqësuesit e Kuvendit Komunal të Rahovecit ku do të shfaqin problemet e tyre, në lidhje me mos zbatimin e ligjit.

Mursel Halili – ai parashtroi pyetje se a është në përbërje të plotë këshilli për Trashëgimin Kulturore të Prizrenit si dhe a është formuar këshilli për fshatin Hoçë e Madhe, siç e obligon Ligji?

Kryesuesja – theksoi se në Rahovec është marrë vendimi për formimin e këshillit për fshatin Hoçë e Madhe por deri sot nuk është formuar, ndërsa Kuvendi Komunal i Prizrenit ka formuar këshillin për trashëgimin Kulturore.

Ajo ceku se komisioni do të organizojë edhe një debat publik ku do të ftohen përfaqësuesit e këshillit lidhur me shkallën e zbatimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Albert Kinolli – i informoi të pranishmit se në bazë të planit të veprimit, Grupi punues është duke e bërë punën rreth zbatimit të Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas, 2009-2015.

Njëherit diskutoi se Komisioni ka mbajtur një debat publik, ku kane marr pjesë zyrtarë të institucioneve të ndryshme, përfaqësues të shoqërisë civile dhe se janë marrë informata të rëndësishme për zbatimin e kësaj strategjie.

Në debatin publik Ministri Agim Çeku, ka veçuar si problem se në Ministrin e Forcës së Sigurisë nuk janë të përfaqësuar sa duhet komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjitian.

Grupi punues ka realizuar vizita të ndryshme, si në Zyrën për Komunitete pran Kryeministrit, Ministrin për Komunitete dhe Kthim, Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe në Ministrin e Shëndetësisë. Në ministrin e Arsimit dhe të Shëndetësisë, është konstatuar se problem janë mjetet financiare mirëpo shtoi se ekziston vullneti që kjo Strategji të zbatohet.

Shqetësim tjetër është se në Komunën e Prizrenit ende nuk përdoret gjuha Rome, si gjuhë zyrtare.

Kryesuesja - ajo ceku se në njërën nga Seancat Plenare të Kuvendit, komuniteti Egjiptian ka kërkuar të mos jetë pjesë e Strategjisë andaj nuk e kupton se si do të vazhdohet me monitorimin e kësaj Strategjie.

Ajo dha informatë shtesë se sa i përket monitorimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, si kryetare e Grupit Punues është emëruar, Jelena Bontic.

Elmi Reçica– theksoi se lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjestarëve të tyre në Republikën e Kosovës janë mbajtur debate publike, janë mbajtur vizita në terren dhe takime të ndryshme.

Në mbledhjen e radhës komisioni do ta shqyrtojë raportin përfundimtar dhe se i njëjti do të dërgohet për shqyrtim në Kryesi.

Kryesuesja – konsideron se Grupet Punuese janë në përfundim të monitorimit të këtyre ligjeve dhe se do të dilet me raporte përfundimtare.

Mbledhja përfundoi, në orën 10:35.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković